



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 8300 2020  
Data: 10.11.2020

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e dhjetë -X- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 20.10.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkyrytar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtarpër Arsim Kulturë Rini dhe Sport), Refet Kalisi Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të N.P.L “Pastrimi” sh.a), Bajrush Laç (Shef i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtarë për Transparencë), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2020.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatim në pronën e paluajtshme të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.
4. Plotësim ndryshimi i rregullores për taksa komunale.
5. Shqyrtimi i raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekondimeve të auditorit.
6. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për NPL “Pastrimi” sh.a.
7. Shqyrtimi i planit të biznesit të N.P.L “Pastrimi” sh.a për vitin 2021.
8. Shqyrtimi i report mbi suksesin e arritur në fund të vitit shkollor 2019/2020.
9. Shqyrtimi i informatës mbi reportin financier për nëntë mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- në tabelën numër dy i keni shpenzimet buxhetore që janë shpenzuar për këtë periudhë. Pagesat nga kategoria ekonomike paga dhe shtesa janë në shumë prej 1,166,961.03 € ose 73.43% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 në pagesat për këtë kategori kemi rritje për 5.59% apo 61,763.55 €. Pagesat për këtë kategori ekonomike mallra dhe shërbime për periudhën janar-shtator 2020 janë në shumë prej 180,134.18 € apo 50.23% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi një shpenzim më të madh për 10,485.60 € apo 6.18%. Pagesat për shpenzime komunale për periudhën nëntëmujore 2020 janë në shumë prej 34,377.14 € apo 55.45% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi rritje për 1,193.46 € apo 3.60%. Pagesat nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere për periudhën janar-shtator 2020 janë në shumë prej 63,755.50 € apo 78.48% e planit vjetor. Ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi një shpenzim më të vogël për 7,971.070 € apo 14.29%. Pagesat nga kategoria ekonomike shpenzimet kapitale janë në shumë prej 296,029.78 € apo 38.81% e planit vjetor. Gjithsejtë shpenzimet për periudhën janar-shtator 2020, për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve janë në shumë prej 1,741,257.63 € apo 58.03% e planit të përgjithshëm vjetor. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- rritja e shpenzimeve duke e krahasuar me vitin e kaluar në përgjithësi aty ku është dashur me u rrit shpenzimet janë zvogëluar dhe aty ku është dashur me u zvogëluar shpenzimet janë rritur, te mallrat dhe shërbimet, dreka zyrtare, ndërsa te investimet dhe subvencionet janë zvogëluar. referencat që është dashur me i marr te viti paraprakë dhe me bërë një plan buxhetorë për vitin vijues dhe me pa se pse po rriten këto shpenzime ku nuk duhet me u rritur. Më mirë është me u zvogëluar shpenzimet në mallra dhe shpenzime e me u rrit në subvencione apo edhe në investime kapitale sepse të lenë me menduar që nuk ka planifikim buxhetorë të mirë për vitet vijuese. Është pak shqetësuese shpenzimi i vogël i buxhetit në disa kategori për shkak se është tre mujori i tretë dhe është 50 % e në tre mujorin e fundit u dashka me plotësuar 50 % apo 60 %, që do të thotë nëntë muaj nuk janë shpenzuar me një përqindje të kënaqshme, ndërsa për tre muaj duhet në mënyrë pak më të shpejtë me i shpenzuar për mos me dal suficit buxhetorë.

**Nora Xhoni** thekson:- sa i përket këtij shpenzimi të buxhetit ndoshta mund të ketë ndonjë tejkalim për arsyet e të pandemisë sepse me një kohë është dashur të ndërpriten të gjitha gjërat pastaj filluan me punuar. Qeveria e Kosovës e ka bërë rishikimin e buxhetit dhe a janë paraparë mjetet përfunksionalizimin e çerdhes.

**Kryesuesi** thekson:- për shkak të procedurave çdo herë tre mujorin e fundit buxheti shpenzohet më shumë e që kjo sidomos vlen te shpenzimet kapitale. Te kategoritë e tjera përafërsisht buxheti njëjtë shpenzohet dhe vërejmë një ndryshim nga viti i kaluar te të hyrat komunale që e dini që i kemi marr disa vendime që një tre mujorin në dy kategori e kemi liruar nga taksa që do të thotë kemi të hyra më pak. Në tre mujorin e patë të vitit te investimet kapitale nuk kemi shpenzime dhe në tre mujorin e fundit është e kuptueshme për shkak se përfundojnë projektet.

**Mallzum Qajani** thekson:- sa i përket shpenzimeve te mallrat e shpenzimet unë mendojë që janë bërë shpenzime dhe për të cilat ende nuk janë kryer pagesat sepse ka pasur shërbime tre mujore dhe kompanitë i dërgojnë faturën dhe ato faturë paguhet për një herë. Shpenzimet te mallrat she shërbimet rriten sepse komuna gradualisht po bënë infrastrukturë e cila donë mirëmbajtje dhe ajo mirëmbajtje kryesish kryhet nga mallrat dhe shërbimet , kështu që shërbimet jo vetëm në komunën tonë do të shkojnë duke u rritur për arsy se rritet sipërfaqja e institucioneve ose e projekteve të ndryshme të cilat kërkojnë mirëmbajtje . Sa i përket rritjes së subvencioneve ne kemi një limit për shpenzime edhe në investime kapitale dhe subvencione kështu që as në rishikim nuk mund ti rrisim. Subvencione në planifikimet buxhetore kemi pas 81 000 €. Investimet kapitale në tre mujorin e dytë për shkak të kufizimeve dhe reduktimit të stafit ka pasur një stagnim për shkak se qeveria ka propozuar që në atë kohë mos me vazhduar me investime kapitale për arsy se nuk është ditur epilogu i koronavirusit në Kosovë dhe si i tillë është menduar se do të ketë shpenzime më të mëdha dhe investimet kapitale me u shpenzuar për nevojat që do të imponohen nga koronavirusi . Në rishikimin e dytë që është bërë nga Qeveria e Kosovës janë lejuar mjetet por janë procedurat për pranimin e stafit dhe përgatitjet teknike të objektit që na mendojmë që në fund të nëntorit apo në fillim të dhjetorit do të fillon me punë çerdhja.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- u potencua çështja e pandemisë unë nuk e kisha arsyetuar sepse planifikimin buxhetorë e keni bërë thuaj se të njëjtë për vitin vijues duke e ditur që veç jemi në pandemi e që i bien me hipotetizëm që paska me kaluar pandemia në vitin 2021. Nëse për shkak të pandemisë kanë ndodhur këto vonesa për vitin 2021 planifikimet të njëjta janë, ju mund ti shikoni krahasimet. Paga dhe shtesa që hyjnë te pagat jubilare që i kanë marr dhe duke një shpenzim më real 73 % dhe krahas këtyre që janë dhënë unë kam kërkuar që të ipen edhe shujtat për të cilat ka një marrëveshje dhe mund të shkon përmes procedurave gjyqisore që do të krijohen shpenzime më shumë.

**Mallzum Qajani** thekson:- politikat financiare i përcakton qeveria dhe qeveria e dërgon qarkoren buxhetore e të cilën komuna është e obliguar ta respektojë që do të thotë ne i kemi respektuar politikat financiare të qeverisë , e në bazë të asaj i kemi bërë planifikimet buxhetore për vitin 2021 sepse nëse duam me bërë na si komunë planifikime të tjera nuk na lejohet . Pagat jubilare për veç shëndetësisë të gjitha sektorëve të tjerë ua kemi dhënë , ndërsa shëndetësisë kemi planifikuat të ja japid në vitin 2021. Është e vërtetë që disa komuna kanë pësuar nga kontrata kolektive dhe mund të na vjen ajo çështje edhe neve por sido çoftë ne edhe më herët kemi dashur me i paguar pagat jubilare por nuk janë procesuar , edhe pagat pas pensionimit kemi dashur çdo herë me i paguar por nuk i ka proceduar Ministria e Financave dhe pas ankesave që janë bërë në gjykatë ne kemi bërë marrëveshje. Sa i përket planifikimeve buxheti është miratuar për vitin 2021 dhe sot kemi të bëjmë me shpenzimet buxhetore.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **3. Shqyrtimi i propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatim në pronën e paluajtshme të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.**

**Kryesuesi** thekson:- duhet të caktohet vetëm norma tatimore për shkak se zonat caktohen nga ministria. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- është një vendim që miratohet për çdo vit kalendarik dhe tatimi është kategori shtetërore jo komunale që përcaktohet me Ligjin për Tatimin në Pronë. Janë të përcaktuara nëntë kategori të pronës dhe Ligji për Tatimin në Pronë i ka limitet e veta që është minimumi i shkallës së tatimit dhe maksimumi. Shkalla 0.15 % është shkalla më e vogël që nuk kemi të drejtë me zbritur më poshtë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nëse mbetet 0.15 % të mbetet edhe te këto dy kategoritë e tjera te njësitë komerciale dhe te njësitë industriale të objekteve. Minimumi ne të përcaktohet në bazë të Ligjit sepse nuk mundemi me i ikur Ligjit.

**Kryesuesi** thekson:- unë besojë që drejtoria e ka përcaktuar minimumin sepse objektet zejtare dhe industriale kanë dallim me pjesën tjetër. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE NË PRONËN E PALUAJTSME TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **4. Plotësim ndryshimi i rregullores për taksa komunale.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- plotësim ndryshimi është propozuar për shkak të vërejtjeve që i kemi marr nga ministritë përkatëse. Propozimet që janë dhënë me ngjyrë të gjerbët plotësohen ndërsa ata të cilat janë me të verdhë hiqen.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te drejtoria për bujqësi janë vetëm me ngjyrë të verdh a ndryshohet diçka apo është bërë ndonjë lëshim.

**Bajrush Laçi** thekson:- këto shtohen sepse nuk kanë qenë po ka mundur të jetë lëshim çështja e ngjyrës por për kuvendë do të ndryshohet

**Nexhmedin Daci** thekson:- te shërbimet kadastrale çmimorja është potencuar që janë në bazë të çmimeve të parapara sipas Udhëzimit Administrativë por duhet listën komplet të shërbimeve dhe produkteve kadastrale me paraqitur në rregullore.

**Mallzum Qajani** thekson:- e kemi marr rregulloren komplet të vitit të kaluar dhe nuk kemi bërë asnjë ndryshim dhe vetëm kemi potencuar që do të vazhdon për vitin 2021 dhe këto ndryshime kanë ndryshuar ndër kohë në ministritë përkatëse dhe ministritë i kanë dhënë këto vërejtje.

**Kryesuesi** thekson:- shërbimet shëndetësore që janë propozuar njëra është me udhëzim administrativ, mirëpo për dy tjerat kërkojë sqarim se çfarë shërbime janë.

**Mallzum Qajani** thekson:- aparati i ri që është blerë në QKMF është në gjendje që ti banë edhe këto analiza Analizat PCR, të kryera në QKMF, çmimi i propozuar nga DSHMS-ja 3 €. Analizat T3, T4, TSH, çmimi i propozuar nga DSHMS-ja 5 € që është statusi hormonal që nuk është bërë asnjë herë në QKMF, ndërsa privat me i kryer është 15 €. Certifikata shëndetësore për punësim është paraparë sipas udhëzimit administrativë.

**Sabedin Hasallari** thekson:- propozoj që kamionët të cilët hynë në pikën kufitare në Han të Elezit të paguajnë taks një apo dy euro dhe me bërë një fond të veçantë për personat të cilët janë të sëmurë prej kancerit apo për një fond për rini dhe sport. Duhet të shikojmë se a kemi të drejtë ligjore.

**Kryesuesi** thekson:- unë mendoj që nuk kemi të drejtë ligjore për këtë çështje sepse kufijtë dihet se kush i menaxhon.

**Mallzum Qajani** thekson:- nuk mund të themi që komuna nuk përfiton prej doganës sepse për çdo vit e marrim buxheti prej nivelit qendrorë për shkak se direkt prej kufirit nuk na vijnë por në mënyrë indirekte vijnë mjetet financiare dhe dërgohen te secila komunë. Të hyrat që hyjnë në doganë janë të hyra në nivel shteti dhe shteti ua kthen komunave në bazë të granteve.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR TAKSA KOMUNALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

##### 5. Shqyrtimi i raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekondimeve të auditorit.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

**Mallzum Qajani** thekson:- sipas rekondimeve të auditorit, komuna në periudhë kohore është e obliguar që të paraqet raport se sa ka implementuar rekondimet e auditorit. Raportet do të janë pjesë të raportimit në kuvend, kështu që ky raport për progresin e zbatimit të rekondimeve është para jush dhe disa rekoamdnime janë zbatuar, disa janë progres e disa nuk janë plotësuar për arsy se kërkojnë kohë për me u implementuar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- prej rekoamdnimeve të dhëna dy janë zbatuar e disa pjesërisht dhe një është e pa zbatuar, mirëpo edhe për rekondimet që potencohet që janë pjesërisht të zbatuara mendoj që janë të pa zbatuara. Rekoamdnimi numër shtatë është për pasuritë kapitale dhe jokapitale, çështja B1 -Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në PFV që unë mendoj që është një keç menaxhim e që nuk është zbatuar.

**Mallzum Qajani** thekson:- rekondimi i shtatë na përcjellë qe dy vite për shkak se është një problem i softëverit, evidentimi digjitalë i pasurive komunale për shkak se janë ndërruar dhe kur është bërë transformimi nga softëveri i vjetër në softuerin e ri komunës së Hanit të Elezit nuk ju ka ruajtur gjendja dhe për shkak të pandemisë nga muaji janar kemi bërë kërkesa të ndryshme në Ministrinë e Administratës Publike që të zgjidhet ky problem. Ne kemi pas problemin për gjendjen që ka shkuar por edhe për gjendjen që ka ardhur për shkak se mallrat që i kemi pranuar nuk kemi mundur që ti registrojmë, kështu që unë mendoj që në muajt në vijim do të rregullohet. Këtë problem nuk e ka vetëm komuna e Hanit të Elezit sepse softueri është në nivel të Qeverisë së Kosovës.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA RAPORTI PERIODIK LIDHUR ME PROGRESIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**6. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për NPL “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani thekson:-** NPL “Pastrimi” sh.a ka parashtruar kërkesë për me u subvencionuar por ju e dini që kjo është një ndërmarrje e re e cila ende nuk i ka ngritur kapacitete dhe për ngritje të kapaciteteve kemi një fond që na ka ndihmuar Qeveria e Kosovës dhe në kuadër të asaj kemi ndarë disa mjete në subvacioneve dhe në bazë të kërkesës është propozuar që NPL “Pastrimi” sh.a për ngritje të kapaciteteve të ndihmohet me 65,000.00 € .

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE PËR NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**7. Shqyrtimi i planit të biznesit të N.P.L “Pastrimi” sh.a për vitin 2021.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kujtim Dernjani thekson:-** me datë 31 për çdo vit duhet të bëhet plani i biznesit për vitin e ardhshëm. Në plan të biznesit janë të parapara shpenzimet e kompanisë, të hyrat dhe pagat e mëditjet. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE PËR NPL “PASTRIMI” SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**8. Shqyrtimi i raport mbi suksesin e arritur në fund të vitit shkollor 2019/2020.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi thekson:-** materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo rekomandim mund të parashtroni.

**U VOTUA RAPORTI I SUKSESIT MBI SUKSESI N E ARRITUR NË FUND TË VITIT SHKOLLOR 2019/2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**9. Shqyrtimi i informatës mbi raportin finansiar për nëntë mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa punëtorë janë të punësuar në kompani.

**Kujtim Dernjani** thekson:- kompania i ka të punësuar 18 punëtorë dhe prej tyre gjashtë janë me kontratë në vepër.

**U VOTUA INFORMATA MBI RAPORTIN FINANCIAR PËR NËNTË MUJORIN E NPL “PASTRIMI” SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**10. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 12:32

**Procesmbajtësi**  
**Ayni Bushi**

